

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0698-A0001*****Në ankesën e******Paditësi*****U S**, nga fshati Sh, Drenas.***Kundër******E paditura/ankuesja*****N.SH K.B "Drenica" (në likuidim)**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0478 të datës 06 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-15-0478 i datës 06 dhjetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 23 prill 2015, paditësi përmes përfaqësuesit dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) NSH KB ,, Drenica" PRN011-0056 të

datës 25 shkurt 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 1,015.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar. Padiësi me ankesë është deklaruar se ankesën e ushtron për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale. Po ashtu padiësi ka propozuar që Gjykata ta ndryshoi Vendimin e AL dhe ta aprovojë kërkesën e padiësit për kompensimin e 7 (shtatë) pagave për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe në emër të borxhit kryesor, ka kërkuar kamatën 10%, sipas nenit 37.3 të Ligjit nr.04/L034. Ka theksuar se Vendimi i AL është në kundërshtim të plotë me nenin 40 pika 1.6.2, të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, sepse padiësi ju është ndërprerë marrëdhënia e punës nga Agjencia.

Padiësi tutje ka theksuar se kërkesa e tij është e bazuar, në nenin 76.7.4 të Ligjit të Punës nr.06/L212, sipas të cilit atij i takojnë pagat duke marrë për bazë përvojën e punës. Më tej ka theksuar se edhe në bazë të nenit 387 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve është paraparë se kur pohohet borxhi, nga ana e debitorit, parashkrimi ndërpritet, kurse pohimi është bërë nga AKP-ja, me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Padiësi ankesës ja ka bashkëngjitur këto prova: Vendimin e AL PRN011-0056, të datës 25 shkurt 2015, Kopjen e formularit të kërkesës kreditore, Vendimin e NSH,, Drenica”, të datës 12 shkurt 2002, për caktimin e kategorive të vendeve të punës dhe të shkallës së koeficientit, Lista e punëtorëve për pranimin e njoftimeve për ndërprerje të marrëdhënies së punës, në të cilën gjendet padiësi me nr. Rendor 41, data e pranimi 27 janar 2010, si dhe konfirmimi i lëshuar nga NSH,, Drenica”, datë 20 qershor 2014, për pagën mujore 145.00 euro.

Me 03 tetor 2017, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja e ka kundërshtuar ekzistencën e detyrimit si të pa bazuar në fakte dhe prova të besueshme. Sipas parashtresës së AKP-së te padiësi është barra e provave sipas nenit 7 të Ligjit për procedurë kontestimore dhe nenit 23 të Ligjit nr.04//033, dhe se padiësi nuk ja ka bashkëngjitur asnjë provë. Tutje AKP-ja pohon se punëtorët kërkesat për paga është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. AKP-ja pohon se ajo nuk ka asnjë dëshmi se padiësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3

vitesh, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me 25 maj 2022 Shkalla e I-re e DHPGJS me Aktvendimin C-IV-15-0478 e ka konsideruara te tërhequr kërkesën e paditësit për shkak të mos pagesë së taksës gjyqësore.

Me 07 qershor 2022, paditësi tek Shkalla e I-rë ka paraqitur propozim për kthim në gjendej të mëparshme.

Me 12 korrik 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS, e ka lejuar kthimin në gjendeje të mëparshëm dhe ka anuluar Aktvendimin C-IV-15-0478 të dt. 25 maj 2022.

Më 21 korrik 2022, paditësi e ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka plotësuar ankesën dhe me parashtresë ka dorëzuar provat: letër konfirmimit e lëshuar nga AKP-ja të datës 21 korrik 2022, një listë të punëtorëve, librezën e punës nr. regjistrin 167, regjistrin e punëtorëve të datës 15 gusht 1997, listën përfundimtare të punëtorëve për 20% dhe kopjen e dokumentit identifikues.

Më 03 gusht 2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, për AKP-në ka lëshuar Urdhër C-IV.15-0478 me të cilin ka kërkuar nga AKP që të dorëzojë të gjitha provat të cilat paditësi i ka dorëzuar me formular të kërkesës kreditore si dhe njoftimin me të cilin paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Më 16 gusht 2022, AKP-ja ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar se provat të cilat i ka dorëzuar paditësi nuk kanë rendësi në kërkesën e tij. AKP-ja kërkesën e ka refuzuar bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034. Me parashtresë ka dorëzuar provat: formularin e kërkesës kreditore, 15 korrik 2014, vendimin për caktimin e punëtorit në vendin e punës 12 tetor 2002, konfirmimin e datës 20 qershor 2014 si dhe Vendimin e AL PRN011-0056.

Më 16 nëntor 2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar urdhër për AKP-në duke i kërkuar të dorëzojë provën e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës për paditësin.

Më 18 nëntor 2022, AKP-ja me parashtresë ka dorëzuar provën njoftimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës për paditësin, datë 01 nëntor 2006.

Me 06 dhjetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-0478 e ka aprovuar si e bazuar pjesërisht ankesën e paditësit, e ka ndryshuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN011-0056 të datës 25 shkurt 2015, ashtu që ka obliguar të paditurën që paditësit U S për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, t'ia paguajë për 4(katër) paga shumën 580.00 euro, kamatën në lartësi 10% të gjitha të paguhen sipas nenit 40 pika 1.6.2, të Shtojcës së ligjit nr.04/L034, ndërsa ka refuzuar si të pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesës mbi 4(katër) paga deri në 7 (shtatë) paga dhe atë mbi shumën 580.00 euro deri në shumën 1,015.00 euro. Në arsyetim të vendimit thuhet se nuk ishte kontestuese se paditësi ishte punëtor i NSH nga 27 qershor 1983 deri me 01 nëntor 2006 dhe se të njëjtit i ishte llogaritur provoja e punës 23.35 vite sipas letër konfirmimit të lëshuar nga AKP me 21 korrik 2022. Shkalla e I-re ka konstatuar se duke u bazuar me provën e Librezës së punës është vërtetuar se paditësi kishte themeluar marrëdhënie të punës, tek e paditura NSH,, Drenica" më 27 korrik 1983 dhe të njëjtit Libreza ju është mbyllur më 01 nëntor 2006, ndërsa me njoftimin e datës 01 nëntor 2006 të lëshuar nga AKP-ja paditësi është informuar në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës, ndërsa sipas njoftimit,, Shuma-Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura. Shkalla e I-rë ka konstatuar se njoftimit i datës 01 nëntor 2006, i lëshuar nga AKP-ja me të cilin paditësit i ka përfunduar punësimi si pasojë e shitjes së aseteve të NSH, ka prodhuar efekt juridik si për paditësin si punëtor ashtu edhe për NSH,, Drenica", si punëdhënësi, sa i përket pushimit të marrëdhënies së punës dhe me këtë dokument e paditura e ka pranuar faktin se shumatat-pagat, të cilat nuk ju janë paguar punëmarrësit mbesin si përgjegjësi e punëdhënësit dhe kërkesat e tilla do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit, duke marrë për obligim që paditësi të kontaktohet kur të fillon kjo procedurë. Shkalla e i-rë ka konstatuar se ky njoftim ka efektin juridik të ndërprerjes së parashkrimit sipas dispozitës së nenit 387 të LMD-së(RSFJ).Në Rastin konkret pas ndërprerjes së parashkrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri nga fillimi, kurse

koha e kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në aftin e caktuar ligjor për parashkrim, krejt kjo sipas dispozitës së nenit 392, paragrafi 1, të LMD-së. Mirëpo nisur nga fakti se AKP-ja ka marrë për obligim ta njoftoi paditësin kur të fillojnë procedurat e likuidimit, ndërsa fillimi i procedurës së likuidimit është varur nga veprimi i AKP-së (si shkak i pezullimit), kjo situatë juridike ka ndikuar që rrjedhja e parashkrimit të pezullohet, pra mos të fillojë rrjedha e parashkrimit dhe një qëndrim i tillë mbështetet në analogji të dispozitës së nenit 384, paragrafi 1, i Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve të RSFJ. Në rastin konkret për shkak të pezullimit të rrjedhës së parashkrimit, parashkrimi fare nuk ka rrjedhë deri në ditën kur paditësi është njoftuar për fillimin e procedurës së likuidimit nga AKP-ja, sipas vendimit të Bordit të AKP-së. Shkalla e I-re ka konstatuar se duke u nisur nga kjo gjendje faktike ka konstatuar se Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar në mënyrë të gabuar edhe dispozitën e nenit 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034.

Shkala e I-rë ka konstatuar se në rastin konkret, paditësit nuk ju është parashkruar kërkesa e tij kreditore dhe se të njëjtit ju njihet e drejta për kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Bazuar në faktin se paditësi kishte stazh pune 23,35 vjet, ndërsa sipas nenit 12, paragrafi, pika (dh) nën (iv), të Ligjit themelor të Punës i vitit 2001, ku është paraparë për 20 vite deri 29 vjet stazh pune punëtorit i takojnë 4 (katër) paga mujore. Ashtu që në rastin konkret duke marrë për bazë pagën mujore 145.00 euro, për katër është gjykuar shuma 580.00 euro, ose $(145 \times 4 = 580)$. Po ashtu shkalla e I-rë ka vlerësuar se ankesa/kërkesa e paditësit në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës për 7 (shtatë) paga në shumën e kërkuar 1,015.00 euro është e bazuar pjesërisht sepse në kohën kur paditësit ju është ndërprere marrëdhënia e punës më datë 01 nëntor 2006, ka qenë në fuqi Ligji themelor i punës i vitit 2001, dhe se në rastin konkret nuk mund të zbatohet ligji i punës, nr.06/L212, që ka paraparë dëmshpërblimin deri në 7 (shtatë) paga. Për këtë arsye gjykata nuk e ka aprovuar kërkesën e paditësit për pjesën mbi 4 (katër) paga dhe ka zbatuar ligjin në fuqi në kohën kur ju është pushuar punësimi i paditësit.

Nisur nga gjendja faktike e lartcekur Shkalla e I-rë e ka aprovuar pjesërisht kërkesën si në dispozitiv, ndërsa e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës mbi 4 (katër) paga ose mbi shumën 580.00 euro, deri në shumën e kërkuar 1,015.00 euro, ndërsa

pjesën e aprovuar të kërkesës ka pranuar kamatën 10% të vlerës themelorë, duke zbatuar nenin 37, paragrafi 3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034.

Me 27 dhjetor 2022, AKP-ja për mes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-IV-14-0478 të datës 06 dhjetor 2022, me të cilën ka propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar duke e refuzuar ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si të pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja me ankesën ka theksuar se Autoriteti ka vërejtur se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra. Autoriteti i Likuidimit nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës parashtruesit i është ndërprerë për shkak të privatizimit. Mirëpo Autoriteti i Likuidimit ka sqaruar shumë qartë se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i likuidimit është i obliguar t'i pranojë dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit e aplikon në mënyrë të drejtë Ligjin. AKP-ja ka theksuar se parashtruesi nuk e saktëson se cili nen i Ligjit 04/-034 është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke shkelur nenin 70.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033 i cili parashikon se Ankesa `duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin 04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, andaj duke marrë parasysh mos respektimin e Nenit 70.2 të Ligjit 04/L034 , ankesa duhet të refuzohet si e pa bazuar.

Me 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit lëshon Urdhër për paditësin i cili mund të parashtrojë përgjigje ndaj ankesës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, por i njëjti nuk parashtruar përgjigje deri në marrjen e këtij vendimi.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 25 korrik 2014, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,015.00 euro nga NSH "Drenica". Kjo kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se edhe ankesa e paditësit e datës 23 prill 2015, i referohet kërkesës për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë, por edhe me parashtresën e dorëzuar më vonë nga AKP-ja si përgjigje ndaj Urdhrit të shkallës së I-rë, paditësi, e ka mbështetur me prova të mjaftueshme kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, duke dorëzuar përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Njoftimit të AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 01 nëntor 2006, fotokopjen e Librezës së punës, dhe dokumentin- konfirmimin mbi lartësinë e pagës të datës 20.06.2014, të lëshuar nga Drejtori i NSH-së. Paditësi sipas këtij dokumenti kishte pagën mujore prej 145.00 euro. Po ashtu edhe nga letër konfirmimi mbi stazhin e punës të lëshuar nga AL me 21 korrik 2022, vërehet se paditësi kishte provoj pune 23.35 vite.

Me këto dëshmi paditësi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që pjesërisht të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, për 4 paga në bazë të përvojës së punës që ai e kishte në NSH.

Prandaj nga këto arsye, e duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar e ka refuzuar si të pabazuar pasi që kjo pjesë e kërkesës nuk është mbështetur në prova materiale.

Kolegji i Apelit në rastet e mbyllura në jurisprudencën e tij, shumë herë ka konstatuar se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërpre në afatin e parashkrimit. Prandaj nuk mund të mbështetet konstatimi i gabuar i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, është parashkruar.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

AKP-ja më 23 janar 2023 e ka paguar taksën gjyqësore konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, andaj nuk ngarkohen me taksë shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 04 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari kryesues _____